



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0530

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e OSHP-së, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Vedat Poterqoi - Kryetar, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE Luigj Kastrati B.I., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit “Intervenimet Emergjente” me numër të prokurimit 611-23-5432-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Drenas, më 28/09/2023, mori këtë:

Vendim

1. **Aprovohet**, si pjesërisht e bazuar ankesa e operatorit ekonomik me numër të protokollit 2023/0530 e datës 30.07.2023 për aktivitetin e prokurimit “Intervenimet Emergjente”, me numër të prokurimit 611-23-5432-5-2-1.

2. **Anulohet** aktiviteti i prokurimit “Intervenimet Emergjente”, me numër të prokurimit 611-23-5432-5-2-1, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Komuna Drenasit.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP-në për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mosrespektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarrë masa ndaj AK, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik në Kosovë.

3. Lejohet të bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

me datë 30.05.2023 Komuna e Drenasit nga cilësia e saj si AK ka publikuar Njoftimin për Kontratë për aktivitetin e prokurimit: “Intervenimet Emergjente”, me numër të prokurimit 611-

23-5432-5-2-1.

Me date 17.07.2023 është publikuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues B58 dhe letrat standarde për tenderuesin e suksesshëm B45, letra standarde për tenderuesin e pasuksesshëm formulari B46 dhe letra standarde për tenderuesin e eliminuar B42.

Me datën 21.07.2023 në AK ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim OE “Luigj Kastrati B.I” të cilën me vendim me datën 24. 07. 2023 AK e ka refuzuar.

Me datë 30.07.2023 OE “Luigj Kastrati B.I” ka ngritur ankesë në OSHP me numër 2023/0530 (numër protokolli).

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

OSHP konstatoi se ankesat në rastin konkret, janë ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesit e kane statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse ankesat përmbajnë elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se të njëjtat i plotësojnë kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe bien nën kompetencat e këtij Organi, në kuptim të nenit 105, të LPP.

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Paneli Shqyrtues dhe ka caktuar po ashtu ekspertin vlerësues, sikurse parashihet me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 17.08.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportet e vlerësimit me rekomandimet:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar;
- Të anulohet vendimi i AK-së;

Administrimi dhe vlerësimi i provave

(a) *Pohimet ankimore të OE "N.T.SH. "Kastrati-L"*

Ankuesi ka pohuar AK ka bërë shkelje të kriterëve të përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT nga ana e AK dhe se në kundërshtim me 108/A, par 8, nen par 8.4 nuk jep as një arsyetim lidhur me pretendimin tone se OE i propozuar për kontratë i plotëson kriteret e përzgjedhjes të parapara në NJK dhe DT, sepse OE në fjalë nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka kryer kontrata të punëve të ngjashme në periudhën e shkuar tri vjeçare sipas kërkesave të DT dhe, rrjedhimisht është i pa përgjegjshëm sepse nuk i plotëson kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale 9.1 & 9.2, Kapaciteti teknik dhe profesional, përkatësisht të kërkesa 3. Të paraqitën kontratat e punëve të ngjashme në tri vitet e fundit nga dita e Publikimit të Njoftimit për Kontratë min. 30,000.00 €. Pra, AK në kundërshtim me dispozitat e nenit 59, par 4 të LPP-së, pa e ekzaminuar siç duhet dhe në përputhje me kriteret e parapara në NJK dhe DT, e trajton të përgjegjshëm OE pa plotësuar kushtin administrativ, sepse Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit.

Sqarimet e ekspertit shqyrtues

Përgjigje në pretendimet ankimore

Lidhur me pretendimin e parë (I) ankimor: fillimisht duhet theksuar që sipas dosjes së tenderit kërkesa nr. 3 në kuadër të kërkesave mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale (9.1 & 9.2) është si në vijim:

Kapaciteti teknik dhe profesional:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

3. Të paraqitën kontratat e punëve të ngjajshme në tri vitet e fundit nga dita e Publikimit të Njoftimit për Kontrat min. 30,000.00€

3. Lista e Kontratave- origjinale - të natyrës së ngjajshme , kopje te kontratave te bashkangjitura me(raportet e pranimeve ose proceseve te pranimeve ose referencave-Njeren prej tyre) ne 3 vitet e fundit, ku identifikohet qarte, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj) , institucioneve publike ose proceset e pranimeve nga personat privat

Sipas pretendimit të parë ankimor tenderuesi i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbyshur këtë kërkesë të dosjes së tenderit me arsyetimin se “*nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme se ka kryer kontrata të punëve të ngjashme në periudhën e shkuar tri vjeçare sipas kërkesave të DT*”. Nga ky këndvështrim ekspertja shqyrtuese ka verifikuar dosjen e dokumenteve me të cilat ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar “Ibrahim Kurrumeli” B.I. Me këtë rast ekspertja shqyrtuese ka gjetur se tenderuesi i rekomanduar për kontratë në ofertën e tij ka bashkangjitur edhe listën e kontratave të realizuara në tri (3) vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë.

Në listën e kontratave të tenderuesit të rekomanduar janë evidentuar 18 kontrata gjithsej me vlerë 1,147,905.46€. Mirëpo tenderuesi i rekomanduar për kontratë ka bashkangjitur dëshmitë e kërkuara dokumentare vetëm për 6 projektet e evidentuara në listën e kontratave si dhe për 2 projekte të tjera të cilat nuk janë evidentuar fare në listën e kontratave. Konkretisht janë bashkangjitur dëshmitë e kërkuara dokumentare për projektet si në vijim:

Kontrata nr. 1 në listën e kontratave “Pastrimi i deponive të egra” me Autoritetin Kontraktues – Komuna e Drenasit në vlerë 12,400.00€. Lidhur me këtë kontratë është bashkangjitur edhe një referencë nga Autoriteti Kontraktues e lëshuar me datë 02.02.2021.

Kontrata nr. 3 në listën e kontratave “Pastrimi i deponive të egra – Faza e dytë” me Autoritetin Kontraktues – Komuna e Drenasit në vlerë 6,600.00€. Lidhur me këtë kontratë është bashkangjitur edhe një referencë nga Autoriteti Kontraktues e lëshuar me datë 12.10.2020.

Kontrata nr. 7 në listën e kontratave “Mirëmbajtja dhe pastrimi i rrugëve rurale gjatë sezonit dimëror” me Autoritetin Kontraktues – Komuna e Lipjani në vlerë 47,866.81€. Lidhur me këtë kontratë është bashkangjitur edhe një referencë nga Autoriteti Kontraktues e lëshuar me datë 15.04.2020.

Kontrata nr. 8 në listën e kontratave “Furnizimi me kripë dhe rërë për mirëmbajtjen e rrugëve” me Autoritetin Kontraktues – Kompania Regjionale e Mbeturinave “Pastrimi” Sh.A. në vlerë 9,898.00€. Lidhur me këtë kontratë është bashkangjitur edhe një referencë nga Autoriteti Kontraktues e lëshuar me datë 19.11.2020.

Kontrata nr. 9 në listën e kontratave “LOT 1 – Pastrimi dhe mirëmbajtja e rrugëve në territorin e Komunës së Skenderajt gjatë sezonit dimëror” me Autoritetin Kontraktues – Komuna e Skenderajt. Lidhur me këtë kontratë është bashkangjitur edhe tri raporte mbi punët e kryera nga

Autoriteti Kontraktues të lëshuara njëra me datë 19.04.2021 në vlerë 88,351.52€ së bashku me faturën me nr. 06/2021, si dhe dy të tjera me datë 05.05.2022 njëra në vlerë 31,648.47€ së bashku me faturën me nr. 05.05.2022 ndërsa tjetra në vlerë 57,143.9€ së bashku me faturën me nr. 07/2022.

Të bashkangjitura me listën e kontratave kanë qenë edhe dëshmitë dokumentare lidhur me kontratën nr. 18 në listën e kontratave mirëpo kjo kontratë nuk është realizuar para datës së njoftimit për kontratë pasi që është e vlefshme deri në vitin 2024. Njëkohësisht janë bashkangjitur dëshmitë dokumentare edhe për dy projekte të tjera mirëpo të cilat nuk janë evidentuar në listën e kontratave.

Sidoqoftë, nga kontratat dhe dëshmitë dokumentare të cituara si më sipër ekspertja shqyrtuese ka gjetur se tenderuesi i rekomanduar e ka përmbushur kërkesën përkatëse të dosjes së tenderit pasi që ka dorëzuar listën e kontratave të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit si dhe ka bashkangjitur dëshmitë e kërkuara dokumentare për kontrata vlera e të cilave kalon dukshëm shumën prej 30,000.00€. Për këto arsye ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimi i parë (I) ankimor është i pabazuar.

Lidhur me pretendimin e dytë (II) ankimor: duhet cekur se operatori ekonomik ankues këtë pretendim e ka prezantuar përmes dy pjesëve të ndryshme. Pjesa e parë manifestohet duke pretenduar se në vendimin me të cilin autoriteti kontraktues ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim të ankuesit, arsyetimi është *‘jo i drejtë dhe jo i duhur’*. Pjesa e dytë manifestohet duke pretenduar se tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmime jo normalisht të ulëta ashtu që ankuesi i merr si shembull çmimet e ofertuara për pozicionet me nr. 9, 10 dhe 11 të paramasës.

Sa i përket pjesës së parë të pretendimit ankimor, duhet theksuar që Autoriteti Kontraktues është i detyruar që të arsyetoj vendimin mbi kërkesën për rishqyrtim në mënyrë të plotë dhe të detajuar. Në rastin konkret ekspertja shqyrtuese vlerëson se ka pasur mundësi që të elaborohen edhe më mirë arsyet mbi të cilat është bazuar vendimi i Autoritetit Kontraktues. Megjithatë ky fakt nuk mund të interpretohet që vendimi në fjalë domosdoshmërisht nuk është i drejtë pasi që në vendimin e Autoritetit Kontraktues megjithatë ekziston një arsyetim në kuptim të përmbushjes së elementeve që duhet të përmbajë një akt administrativ sipas nenit 47 paragrafit 1 të ligjit në fuqi për procedurën e përgjithshme administrative.

Sa i përket pjesës së dytë të pretendimit ankimor, duhet cituar nenin 41 paragrafin 41.3 të RRPP ku është përcaktuar se: *“Autoritetet kontraktuese do të kërkojnë nga operatorët ekonomik për të shpjeguar çmimin e ofruar për tenderët e përgjegjshëm, kur të përmbushen të gjitha kushtet e mëposhtme:*

- i. çmimi i ofruar është më shumë se 30% më i ulët se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm;*
- ii. çmimi i ofruar është më shumë se 10% më i ulët se çmimi ose kostot e tenderit të dytë më të ulët;*
- iii. janë dorëzuar të paktën 3 (tre) tenderë”.*

Në aktivitetin e prokurimit për të cilin po bëhet fjalë janë dorëzuar tre (3) tenderë mirëpo vetëm dy (2) prej tyre janë të përgjegjshëm (ankuesi dhe tenderuesi i rekomanduar). Çmimi total i peshuar me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është 93 euro ndërsa ankuesi ka ofertuar me 1397.75 euro. Në rastin konkret çmimi total i peshuar me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është dukshëm më shumë se 30% më i ulët sesa se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm mirëpo njëkohësisht është edhe dukshëm më shumë se 10% më i ulët se çmimi i ankuesi i cili konsiderohet si tenderuesi i dytë më i ulët në rastin konkret.

Mirëpo edhe sa i përket pozicioneve të specifikuar në ankesë:

- në pozicionin nr. 9 tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmimin prej 7 euro ndërsa ankuesi me 35 euro;
- në pozicionin nr. 10 tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmimin prej 10 euro ndërsa ankuesi me 28 euro;
- në pozicionin nr. 11 tenderuesi i rekomanduar ka ofertuar me çmimin prej 10 euro ndërsa ankuesi me 25 euro.

Në të tri pozicionet si më sipër, çmimi me të cilin ka ofertuar tenderuesi i rekomanduar është dukshëm më shumë se 30% më i ulët sesa se çmimi mesatar i tenderëve të përgjegjshëm mirëpo njëkohësisht është edhe dukshëm më shumë se 10% më i ulët se çmimi i ankuesi i cili konsiderohet si tenderuesi i dytë më i ulët në rastin konkret.

Në këtë mënyrë ekspertja shqyrtuese konsideron se janë plotësuar të gjitha kriteret e përcaktuara me nenin 41 paragrafin 41.3 të RRPP. Me këtë rast duhet cituar nenin 41 paragrafin 41.4 të RRPP ku përcaktohet se *“Kur tenderët duken të jenë jo-normalisht të ulët për arsye të tjera nga ato të parashikuara në paragrafin 41.3 të kësaj rregullore, autoritetet kontraktuese mund të vlerësojnë besueshmërinë e tenderëve të tillë dhe rrjedhimisht të kërkojnë shpjegime në përputhje me paragrafët e mëposhtëm dhe nenin 61 të LPP-së”*. Po ashtu përmes nenit 61 paragrafit 1 të LPP është përcaktuar se *“Nëse një operator ekonomik e dorëzon një tender që, është ose duket të jetë jo-normalisht i ulët, autoriteti kontraktues do të dërgojë një kërkesë me shkrim tenderuesit ku kërkohet nga tenderuesi që të dorëzojë me shkrim : (i) një ndarje të elementeve përbërëse të tenderit dhe (ii) shpjegime në lidhje me bazën e tenderit, sipas paragrafit 2. të këtij neni”*.

Nga dokumentet e ngarkuara në sistemin e-prokurimi nuk evidentohet se Autoriteti Kontraktues ka kërkuar sqarime prej tenderuesit të rekomanduar lidhur me çmimet jo normalisht të ulëta. Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenin 61 paragrafin 1 të LPP lidhur me nenin 41 paragrafët 41.3 dhe 41.4 të RRPP. Për këto arsye ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimi i dytë (II) ankimor është i bazuar.

Lidhur me pretendimin e tretë ankimor fillimisht duhet cituar se përmes nenit 27 paragrafit 27.16 të RRPP është përcaktuar se *“Autoriteti Kontraktues do të përcaktoj në Dosjen e Tenderit peshën (rëndësinë) e çmimeve të kategorive specifike, dhe do të artikuloj rëndësinë në përqindje(%). Përqindja (%) totale do të jetë 100%”*.

Po ashtu edhe KRPP përmes interpretimit nr. 28 të datës 09.06.2023 ndër të tjera ka sqaruar se *“Numri i kategorive dhe norma e peshimit për kategori, varet nga lloji i shërbimit (në praktikë më të mira nuk duhet të jetë më pak se tri kategori), por norma e përqindjes së*

peshimit (poentimit) e të gjitha kategorive së bashku, nuk lejohet të jetë më shumë se 100%”.

Në formularin e çmimore të ngarkuar në sistemin e-prokurimi lidhur me këtë aktivitet është përcaktuar norma e përqindjes së peshimit si në vijim:

Rikapitullim i përgjithshëm
Totali A prej (1-2) me 10
Totali B prej (3-6) me 60%
Totali C prej (7-8) me 60%
Totali D prej (9-12) me 30%
Totali E prej (13-14) me 10%
Totali (A+B+C+D+E)

Me këtë rast Autoriteti Kontraktues ka përcaktuar normën e peshimit në 170% duke e tejkaluar normën prej 100%. Rrjedhimisht ka vepruar në kundërshtim me dispozitën e cituar më sipër si dhe me interpretimin përkatës të KRPP. Për këto arsye ekspertja shqyrtuese vlerëson se pretendimi i tretë (III) ankimor është i bazuar. Rrjedhimisht ekspertja shqyrtuese konsideron se kjo shkelje e pamundëson që ky aktivitet i prokurimit të përmbushë qëllimin e tij në përputhje me parimet e LPP në kuptim të nenit 1 lidhur me nenin 6, 7, 27, 28, *et.al.* të LPP. Kjo pasi që në rastin konkret dhe në fazën në të cilën ndodhet ky aktivitet i prokurimit, shkelja e ligjit që ka ndodhur nuk mund të rregullohet ose parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit. Në këtë drejtim përmes nenit 62 paragrafit 1 nënparagrafit 1 të LPP përcaktohet se Autoriteti Kontraktues mund të përfundojë një aktivitet të prokurimit nëse “*një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit*”. Në këtë kontekst ekspertja shqyrtuese vlerëson se janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit sipas nenit 62 paragrafit 1 nënparagrafit 1 të LPP. Kuptohet se Autoriteti Kontraktues me rastin e ri shpalljes së këtij aktiviteti të prokurimit duhet të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme për të evituar përsëritjen e shkeljeve ligjore të evidentuara me këtë ekspertizë.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues -

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, prandaj analizoi të gjitha shkresat e

kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca publike me palë sepse ka prova të mjaftueshme për të vendosur sipas paragrafit 1, të nenit 24 të Rregullores së cituar. Paneli në këtë rast mori në konsideratë të gjitha pohimet ankimore, aktet dhe veprimet e AK dhe raportin e ekspertit.

Në fakt (natyrisht pavarësisht nga rekomandimet) Paneli vëren se procedura e prokurimit e cila është aplikuar në këtë rast është prezantuar në raportin e ekspertit shqyrtues, duke i shpjeguar fazat e procesit dhe veprimet e ndërmarra nga palët në kontekstin krahasues me aktet në fuqi, posaçërisht me Rregullat për Prokurim Publik.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportin e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime lidhur me pohimet ankimore. Prandaj Paneli shqyrtues nuk do të lëshohet tek pretendimet tjera por do të ndalet vetëm tek pretendimi ankimor i renditur si i treti me radhë në raportin e ekspertizës sepse me këtë pretendim përcaktohet edhe vendimarrja, ku paneli shqyrtues e mbështet shpjegimet e ekspertit shqyrtues i cili i ka shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij, se peshimi i kategorive në përshkrim të çmimi nuk është bërë konform dispozitave ligjore dhe si i tillë ka bërë që të përmbushen kushtet për anulim e këtij aktiviteti të prokurimit sipas nenit 62 të LPP.

Paneli shqyrtues ka analizuar me kujdes të gjitha pretendimet ankimore, përfshirë të gjitha veprimet, aktet dhe korrespondencën mes palëve dhe nga ky kontekst mund të kuptohet AK nuk ka respektuar në tërësi dispozitat ligjore ashtu siç janë të sanksionuara me nenit 1, 6, 7, 27 të LPP, Si rezultat i kësaj vendos që të anulohet në tërësi aktiviteti i prokurimit.

Gjatë procesit të shqyrtimit dhe vendosjes, Paneli vuri si gjithnjë në zbatim edhe nenin 1, 6, 27, të LPP-së sipas të cilëve të gjitha palët e interesuara do të kenë qasje të barabartë në procedurat për shqyrtimin e prokurimit dhe në mjetet juridike dhe se asnjë vendim i OSHP, nuk do të merret në mënyrën me të cilën diskriminohet në të mirë ose në dëm të një subjekti në procedurë.

Andaj nga të lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Vedat Poterqoi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA GLLOGOC**
- **OE - Luigj Kastrati B.I.**
- Arkivës së OSHP-së: